

Adrian Bajrami-Kryetar i Parlamentit Studentor

I nderuar Rektor z. Kosumi

Te nderuar Anëtarë të Këshillit Drejtues

Te nderuar Prorektor ,Dekan, Staf Akademik, Administrativ dhe ju të dashur studentë

Sot po festojmë 6 vjetorin e themelimit të UKZ-së dhe ndjehem moralisht i obliguar të falënderoj çdo student për kontributin e tyre të pakursyer në formësimin e Universitetit, të cilët gjithnjë ishin aty kur ishte interesi i universitetit.

Është kënaqësi gjithashtu dhe përgjegjësi që sot të ju drejtohem në emër të gjithë studentëve duke ju uruar 6 vjetorin e themelimit të UKZ-së.

Parlamenti Studentor me përgjegjësi të lartë ka kryer detyrat e saj, ku në krye të PS ka zgjedhur studentët me të dalluar dhe kështu duke e ndihmuar zhvillimit e universitetit, me ç'rast fokus kryesor ka pasur aktivitetet që kanë të bëjnë me ngritjen e cilësisë, si debate, trajnimet që kanë qenë shumë dobiprurëse për studentët.

Në punën tonë të përditshme ne kemi komunikim-mirëkuptim dhe bashkëpunim të shkëlqyer. Të gjitha këto edhe më shumë i plotëson fryma e bashkëpunimit në mes PS dhe Menaxhmentit.

Ne rrugëtimin tone kemi hasur në shume vështirësi por e mira e gjithë kësaj që vlen të përmendet është se në Universitetin “KadriZeka” gjithmonë ka ekzistuar një adresë ,ka ekzistuar dikush që merret me këto problem e ata i kemi këtu pranë: Rektorin, Prorektorët, Dekanët, Prodekanët çka dua edhe t'i falënderoj përzemërsisht!

Uroj që përkushtimi i tillë nga ana e menaxhmentit, studentëve të vazhdoj edhe tutje duke i përmbushur objektivat tona afatgjata dhe Universiteti “Kadri Zeka” të jetë lider i cilësisë, me studentët te cilët janë model për suksese në rajon dhe më gjere.

URIME!